

**VENDIM  
(QARKULLUES)**

**Nr. 16, Datë 18.12.2013**

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË STATUTIN E UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Senati i Universitetit të Arteve në datën 18.12.2013, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, për disa shtesa e ndryshime në statutin e Universitetit të Arteve,

**VËREN**

Statuti i Universitetit të Arteve përbën një nga dokumentet themelore që rregullon veprimtarinë akademike e administrative të UART, në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë. Ky dokument është miratuar nga Senati Akademik i UART si dhe nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Statuti është një dokument në tërësinë e tij i qëndrueshëm në kohë, megjithatë rast pas rasti, në referim edhe të parashikimeve ligjore dhe detyrimeve që lindin për Universitetin e Arteve, ky dokument ka nevojë për shtesa apo ndryshime, pra në tërësi rregullime të ndryshme, të cilat duhet të diskutohen e miratohen nga Senati Akademik.

Nga praktika e përditshme e jetës akademike ka lindur nevoja për rregullimin e disa çështjeve të patrajtuara më parë nga Statuti i UART:

- Statuti i UART nuk ka trajtuar në mënyrë specifike fenomenin e "diskriminimit", një fenomen ky i cili është konstatuar edhe në shkollën tonë. Në Fakultetin e Muzikës është konstatuar një rast diskriminimi, nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili në Vendimin e tij për çështjen në fjalë ka paraqitur edhe disa rekomandime lidhur me zgjidhjen dhe rregullimin e situatës. Ndër rekomandimet e paraqitura është edhe ai që lidhet me parashikimin e procedurave për trajtimin nga ana e UART, të çështjeve të diskriminimit. Nisur nga struktura ekzistuese e shkollës sonë, si dhe përcaktimeve në Statutin e UART, mendohet se Këshilli i Etikës do të ishte autoriteti më i përshtatshëm për shqyrtimin e çështjeve që ngrihen në UART, me objekt diskriminimin. Shqyrtimi i këtyre çështjeve nga ana e Këshillit të Etikës kërkon shtesa në nenet përkatëse të Statutit të UART (nenet 28 dhe 29), me qëllim përcaktimin e shprehur të kompetencës për shqyrtimin e rasteve të diskriminimit. Këshilli i Etikës do të ketë tagrin që të shqyrtojë ankimet e paraqitura për diskriminim si dhe që të konstatojë nëse ka ose jo diskriminim, duke paraqitur rekomandimet përkatëse. Rektori i UART do të jetë

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al  
përgjegjës për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Etikës. Nga ana tjetër ky ndryshim në Statut kërkon edhe ndryshimet përkatëse në Kodin e Etikës.

- Çështje tjetër që lidhet me ndryshimet në Statut ka të bëjë me përcaktimin e shprehur për dhënien e masave disiplinore ndaj personelit akademik. Masat disiplinore rregullohen nga dispozitat e Kontratës së Punës si dhe nga Kodi i Punës i RSH, por në Statut nuk ka një parashikim të shprehur lidhur me këtë çështje në referim të personelit akademik. Një rregullim i tillë në statut e bën statutin më të plotë nga pikëpamja rregullative. Për këtë arsye shtohet në Statut një nen i veçantë që rregullon këtë çështje
- Për sa më sipër, Senati Akademik i Universitetit të Arteve, bazuar në nenin 39, pika 2 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në RSH", i ndryshuar,

### VENDOSI

1. Në nenin 28, pika 2 në fund të fjalisë, shtohen fjalët "*, si dhe shqyrtimin e kërkesave për diskriminim në UART.*"
2. Në nenin 29, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje "*5. Kërkesa për diskriminim i paraqitet Këshillit të Etikës nga çdo anëtar i Universitetit të Arteve.*"
3. Në nenin 110 të Statutit të UART, germa "dh" e pikës 3 shfuqizohet.
4. Pas nenit 110 të Statutit të UART, shtohet neni 110/1 me këtë përmbajtje:  
*"Neni 110/1, Masat disiplinore dhe procedura e dhënies së masave disiplinore për personelin akademik.*
  1. *Për personelin akademik në Universitetin e Arteve jepen këto masa disiplinore:*
    - a. *Vërejtje;*
    - b. *Vërejtje me paralajmërim;*
    - c. *Largim nga detyra.*
  2. *Masat disiplinore për personelin akademik jepen nga Rektori i Universitetit të Arteve, me iniciativën e tij apo me propozim të Dekanit të Fakultetit, Këshillit të Etikës, etj. Procedura për dhënien e masës disiplinore duhet të garantojë të drejtën për tu informuar, për tu dëgjuar dhe për tu mbrojtur për punonjësin akademik.*
  3. *Procedura e dhënies së masës disiplinore të përcaktuar në gerrat a dhe b të pikës 1 të këtij neni është si më poshtë:*
    - a. *Subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, i propozojnë Rektorit dhënien e masës disiplinore, duke përcaktuar qartësisht emrin dhe mbiemrin si dhe pozicionin e punës së punonjësit akademik, ndaj të cilit propozohet dhënia e masës disiplinore. Propozuesi përcakton gjithashtu, shkëljet e konstatuara dhe arsyet përse propozohet dhënia e masës disiplinore;*



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

b. Rektori, pasi konsideron propozimin, nxjerr urdhër për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore. Urdhri përcakton punonjësin akademik ndaj të cilit fillon procedura, si dhe arsyet për fillimin e procedurës. Urdhri përcakton edhe afatin kohor brenda të cilit punonjësi akademik duhet të paraqesë mbrojtjen dhe argumentet e tij. Punonjësit akademik i lihet një afat prej 10 ditësh.

c. Rektori, pasi administron praktikën e propozimit, së bashku me mbrojtjen dhe argumentat e punonjësit akademik, mund të kërkojë dokumente apo prova të tjera shpresore, apo edhe të pyesë punonjës apo autoritete të tjera lidhur me çështjen.

ç. Rektori brenda 30 ditësh nga paraqitja e mbrojtjes së punonjësit akademik, pasi ka shqyrtuar praktikën përkatëse, merr vendim për dhënien e masës disiplinore ose jo. Mos shprehja nga ana e Rektorit brenda këtij afati, konsiderohet si refuzim i propozimit për dhënien e masës disiplinore.

d. Vendimi i rektorit për dhënien ose jo të masës disiplinore shprehet me Urdhër, i cili i bëhet i njohur propozuesit për dhënien e masës disiplinore, si dhe punonjësit akademik për të cilin u zhvillua procedura.

4. Procedura e dhënies së masës disiplinore "largim nga detyra" bëhet në përputhje me dispozitat e parashikuara nga Kodi i Punës."

5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet publikisht.

6. Kryetari i Senatit Akademik i dërgon zyrtarisht Ministrit të Arsimit dhe Sportit, këtë Vendim, me qëllim shprehjen për ligjshmërinë e dispozitave të ndryshuara të Statutit.

#### SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE